



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 462/ 2010**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e Avdi Smajlaj, sekretar i Subjektit Politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partisë Demokratike e Kosovës (PDK) për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 13.12.2010, mori këtë:

## **V E N D I M**

**REFUZOHET** ankesa si e pabazuar e subjektit politik Aleanca Kosova e Re

### **A r s y e t i m**

Avdi Smajlaj nga radhët e subjektit politik AKR dega në Prishtinë, ka parashtruar ankesë kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), duke pretenduar se në shkollën fillore “Dardania” në Qendrës Votimit 1904 militantët e PDK-së kanë qëndruar në korridore të shkollës për ti orientuar votuesit se ku të votojnë dhe se policia nuk ka ndër marrë asgjë.

Më 12 dhjetor 2010, PZAP-i ka pranuar një ankesë që i ishte dorëzuar nga AKR, duke pretenduar se militantët e subjekti politik PDK, kanë shkaktuar parregullsi gjatë procesit të votimit në ditën e zgjedhjeve.

**Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon**

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

- (c) *hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku*

*mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat lëndës gjeti se:

**- ankesa është e pabazuar**

Prandaj duke e shqyrtuar dhe analizuar ankesën e AKR-së përfundojmë se ankesa në fjalë ka mungesë të provave për t'u bindur se militantët e PDK-së kanë shkaktuar parregullsi dhe se nuk kanë ofruar asnjë prova si dëshmi bindëse për parregullësin e pretenduar. PZAP-i konsideron që AKR nuk ka vepruar në pajtim me nenin 3.6 pika (c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

A nr. 462/2010 më datën 13.12.2010.

